



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1086/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 123-të, mbajtur me datë 20.05.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Master i Shkencave të Edukimit MA 120 ECTS me specializimet: 1. Këshillim pedagogjik, 2. Edukim Inkluziv, 3. Udhëheqja në Arsim, dhe 4. Mësimdhënia dhe Kurrikula, me kuotën maksimumi 160 studentë për vit akademik (secili specializim nga 40 student);*
- II. Akreditohet programi i studimit i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 2. *Master ne Inovacion dhe Cilesi ne Edukim MA 120 A me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve si në paragrafin I dhe II zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim nga KShC.

VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.

VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Master i Shkencave të Edukimit MA 120 ECTS, me specializimet: 1. Këshillim pedagogjik, 2. Edukim Inkluziv, 3. Udhëheqja në Arsim, dhe 4. Mësimdhënia dhe Kurrikula</i>	Naser Zabeli, Vlora Sylaj Ardita Devolli Fjolla Kaçaniku Arlinda Beka
2.	<i>Master në Inovacion dhe Cilësi në Edukim MA 120 ECTS A</i>	Blerita Perolli Shehu Iliriana Tahiraj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Master i Shkencave të Edukimit MA 120 me specializimet: 1. Këshillim pedagogjik, 2. Edukim Inkluziv, 3. Udhëheqja në Arsim, dhe 4. Mësimdhënia dhe Kurrikula***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Juliette Torobian, Elene Jibladze dhe Domagoj Svigir është organizuar më 29.03.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) dhe Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; *Master në Inovacion dhe Cilësi në Edukim MA 120 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Elene Jibladze, Juliette Torobian, Milan Pol dhe Domagoj Svigir është organizuar më 29.03.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 123-të, të mbajtur më datë 20.05.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,




Prof. Asoc. Dr. Hasnija Nazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë